Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-471
Datë: 04.08.2023

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060, për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ për Njohjen e Mësimit Paraprak (UA Nr. 31/2014, data 05.09.2014), dhe Udhëzimit Administrativ për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë (UA Nr.09/2019, data 18.06.2019), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur më datë 03.08.2023 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Ri-Akreditohet** Professional Beauty Academy – rr. Bulevardi "Bill Clinton", Prishtinë, Republika e Kosovës , për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 30.12.2022 deri 29.12.2026, për zbatimin e Njohjes se Mësimit Praraprak (NjMP), me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK)

   1.1 **Parukier, niveli III sipas KKK,** lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 35 kredi të AAP. IAAP mund të përfshijë në procesin e NJMP deri në dymbëdhjetë (12) kandidatë brenda muajit, dhe gjatë një viti mund të vlerësohen deri në njëqind e katërdhjetë e katër (144) kandidatë nëpërmjet NjMP.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së PROFESIONAL BEAUTY ACADEMY, për ri-akreditim të zbatimit të NjMP dhe rekomandimeve të dala nga raporti i ekipit të ekspertëve për ri-akreditimin e institucioneve që zbatojnë NjMP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për ri-akreditim për zbatimin e NjMP, Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin

ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. PROFESIONAL BEAUTY ACADEMY;
2. Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK